

VENDIM
Nr.319, datë 18.4.2020

**PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË DHE TË
FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE,
PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 17, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të grupit 87 “Institucioneve të tjera qeveritare”, për vitin 2020, shtohet me 7 (shtatë) punonjës për Njësinë Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij grupi në 1 204 (një mijë e dyqind e katër) punonjës.

2. Numri i punonjësve të Kryeministrit, për vitin 2020, reduktohet me 7 (shtatë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) punonjës.

3. Në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, të miratuar për vitin 2020 për Kryeministrinë, reduktohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, në zërin “shpenzime korrente”.

4. Në programin “Shërbime të tjera”, të miratuar për vitin 2020, për grupin 87 “Institucioneve të tjera qeveritare”, shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, në zërin “shpenzime korrente”.

5. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama